

# GJYKATA E APELIT

**Lënda nr:** PAKR 966/2012

**Data:** 11 shtator 2013

**GJYKATA E APELIT NË KOSOVË** me Trupin Gjykses të përbërë nga Gjykatësi nga EULEX Tore Thomassen në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykses dhe Gjykatësit Raportues, Gjykatësi nga EULEX Bertil Ahnborg dhe Gjykatësja nga Gjykata e Apelit në Kosovë Fellanza Kadiu në cilësinë e anëtarëve të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Andres Parmas, Zyrtar Ligjor nga EULEX në cilësinë e Proces-Mbajtësit në lëndën penale ndaj:

**S.G.**, nofka “Qopa”, në paraburgim që nga 6 maj 2010. S.G. akuzohet me gjashtë pika të akuzës për **Krime lufte kundër popullatës civile** në kundërshtim me nenin 142, Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), poashtu të paraparë edhe me nenet 23 dhe 120, Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe në kundërshtim me Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës (KGj) dhe nenet 4 dhe 5(1) të Protokollit Shtesë II Konventave të Gjenevës (PSh II); dhe **pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve** në kundërshtim me nenin 328(2), KPK;

**R.A.**, nofka “Komandant Hoxha”, në paraburgim që nga 23 qershor 2010. R.A. akuzohet me tre pika të akuzës për **Krime lufte kundër popullatës civile** në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, KPRSFJ, poashtu të paraparë me nenet 23 dhe 120, KPK, dhe në kundërshtim me nenin e përbashkët 3, KGj dhe nenet 4 dhe 5(1), PSh II;

**H.H.**, nofka “Haki Drenica”. H.H. akuzohet me dy pika të akuzës për **Krime lufte kundër popullatës civile** në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, KPRSFJ, poashtu të paraparë me nenet 23 dhe 120 KPK, dhe në kundërshtim me nenin e përbashkët 3, KGj dhe nenet 4 dhe 5(1), PSh II;

**S.H.** S.H. akuzohet me dy pika të akuzës për **Krime lufte kundër popullatës civile** në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, KPRSFJ, poashtu të paraparë me nenet 23 dhe 120, KPK, dhe në kundërshtim me nenin e përbashkët 3, KGj dhe nenet 4 dhe 5(1), PSh II dhe

**S.R.** S.R. akuzohet me katër pika të akuzës për **Krime lufte kundër popullatës civile** në kundërshtim me nenet 22 dhe 142, KPRSFJ, poashtu të paraparë me nenet 23 dhe 120, KPK, dhe në kundërshtim me nenin e përbashkët 3, KGj dhe nenet 4 dhe 5(1), PSh II

*Duke vepruar ndaj ankesave si në vijim të ushtruara kundër Aktgjykimit P 45/10 në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë:*

Ankesa e Avokatëve Mbrojtës Mahmut Halimi dhe Haxhi Millaku për të pandehurin S.G.;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Gezim Kollcaku për të pandehurin R.A.;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Gani Rexha për të pandehurin H.H.;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Agim Lushta për të pandehurin S.H.;

Ankesa e Avokatit Mbrojtës Qasim Qerimi për të pandehurin S.R.

*Me të konsideruar* mendimin dhe parashtresën e Prokurorit të Apelit Judit Eva Tatrai nr. PPA 153/12, datuar 25 janar 2013;

*Pas mbajtjes së seancës së hapur për publikun më 10 shtator 2013 në prani të Prokurorit të Apelit Judit Eva Tatrai, të pandehurve S.G., R.A., H.H., S.H. dhe S.R. dhe avokatëve të tyre mbrojtës Mahmut Halimi, Gezim Kollcaku, Gani Rexha, Agim Lushta dhe Qasim Qerimi;*

*Me të pleqëruar dhe votuar më 11 shtator 2013,*

*Në pajtim me Nenet 420 (1.4) dhe 426 (1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Kosovë (KPPK)*

*Sjellë si në vijim*

---

## AKTGJYKIM

---

**1. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, datuar 29 korrik 2011 në lëndën penale nr. 45/10 modifikohet si në vijim:**

**1.1. S.G. shpallet fajtor për krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me Nenin 142, KPRSFJ, poashtu të paraparë me Nenet 120 dhe 121, KPK, dhe në kundërshtim me Nenin e Përbashkët 3, KGj dhe Nenet 4 dhe 5 (1), PSh II, për shkak se:**

**1) Nga apo rreth datës 18 maj deri më 3 qershor 1999, gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

- (“UÇK”), duke mbajtur post komandues në burgun e improvizuar brenda bazës ushtarake të UÇK-së në qytetin e Kukësit të Republikës së Shqipërisë, së bashku me anëtarët e tjerë të UÇK-së ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore (p.sh. kushte të pista jetese, mungesë e kushteve adekuate higjienike, ushqimit dhe ujit) një numër të papërcaktuar të të burgosurve civilë, përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED];
- 2) Më apo rreth datës 19 maj 1999, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së me post komandues në burgun në kampin e UÇK-së në Kukës, në bashkë-kryerje me anëtarë të tjerë të UÇK-së, torturoi të burgosurit civilë: Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED] duke u përpjekur të merr informata dhe pohime nga viktimat nëpërmjet ushtrimit të vazhdueshëm të dhunës ndaj tyre dhe urdhërimit të ushtarëve të UÇK-së të bëjnë të njëjtën gjë;
  - 3) Disa herë nga apo rreth datës 18 maj deri më 3 qershor 1999, gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), në post komandues në burgun e UÇK-së në kampin në Kukës, dhunoi integritetin trupor të një numri të papërcaktuar të të burgosurve civilë përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED] nëpërmjet keqtrajtimit të rëndë dhe rrahjeve brenda qelive të improvizuara ku të burgosurit në fjalë janë mbajtur;
  - 4) Më apo rreth datës 12 prill 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së në bashkë-kryerje me R.A.jn, dhunoi integritetin trupor të I.I.t, civil i ndalur në burgun e improvizuar në kampin e UÇK-së në Cahan të Republikës së Shqipërisë duke e rrahur rëndë dhe në mënyrë të vazhdueshme me patericë dhe shkop druri.

**1.2. R.A. është shpallur fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile, në kundërshtim me Nenin 142 KPRSFJ, gjithashtu paraparë me nenet 120 dhe 121, KPK, dhe në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1), PSH II sepse ai:**

- 1) Më apo rreth datës 12 prill 1999, gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me S.G.n, ka dhunuar integritetin trupor të I.I.t, një civil i ndalur në një burg të improvizuar në kampin e UÇK-së në Cahan të Republikës së Shqipërisë, duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritur dhe të rëndë me patericë dhe me një shkop druri;

2) Gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e anëtarit të UÇK-së, ka dhunuar integritetin trupor të civilëve të ndaluar në burgun e UÇK-së, në kampin e Cahanit:

- I.I., duke rrahur atë në disa mënyra përfshirë edhe goditjen e tij me një këpucë të rëndë më apo rreth datës 14 prill 1999, dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK-së të godasin me grushta dhe shkelma I.I.t gjatë disa rasteve të papërcaktuara (sidomos kur I.I. shkonte në nevojtoje nga qelia ku mbahej i ndaluar) gjatë datave të papërcaktuara mes datës 12 prill dhe mesit të qershorit 1999;

- Dëshmitarin M, duke e goditur atë vazhdimisht në kurriz me një shufër metalike më datë apo rreth datës 17 prill 1999;

- Dëshmitarin K, Dëshmitarin M, Dëshmitarin N, dhe Dëshmitarin O duke i rrahur ata në mënyra të ndryshme, duke i goditur ata me shkop druri dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK-së për t'i rrahur ata, gjatë datave të papërcaktuara mes 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999.

1.3. S.G. dënohet me 15 vjet burgim për Krime lufte kundër popullatës civile.

1.4. R.A. dënohet me 12 vjet burgim për Krime lufte kundër popullatës civile.

2. Vërtetohet pjesa tjetër e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, datë 29 korrik 2011.

3. Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, datë 13 tetor 2011 në lëndën penale nr. 45/10.

4. Ankesat e Avokatëve Mbrojtës të S.G.t dhe R.A.t aprovohen pjesërisht, siç është përcaktuar më lart.

5. Ankesat e Avokatëve Mbrojtës të H.H.t, S.H.t dhe S.R.t refuzohen si të pabazuara.

## ARSYETIMI

### **I. Historiku Procedural**

#### **A. Akuzat ndaj të pandehurve**

1. Më datë 6 gusht 2010, Prokurori i PSRK-së ushtroi aktakuzën PPS nr. 08/2009 kundër të pandehurve S.G. dhe R.A. dhe akuzoi ata për veprat penale Krime lufte kundër popullatës civile në pajtim me nenet 22 dhe 142, KPRSFJ që aktualisht penalizohet me nenet 23 dhe 120 (2) KPK për shkak të akteve që kanë kryer kundër të ndaluarve civilë të ndaluar në dy kampet e UÇK-së në Kukës dhe Cahan të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 1999. S. Geci

akuzohej gjithashtu edhe për armëmbajtje pa leje. Aktakuza u konfirmua me anë të Aktvendimit KA nr. 64/2010 më datë 24 nëntor 2010.

2. Më datë 29 dhjetor 2010, Prokurori i PSRK-së ushtroi Aktakuzën PPS nr. 117/2010 kundër H.H.t dhe S.R.t duke i akuzuar ata për Krime lufte kundër popullatës civile për shkak të keqtrajtimit të të ndaluarve civilë në një kamp ndalimi të UÇK-së në Cahan, Shqipëri gjatë 1999. Më datë 16 shkurt 2011, Prokurori parashtroi një Aktvendim për zgjerimin e hetimit penal në lëndën PPS nr. 117/2010 për të përfshirë si të dyshuar S.H.n. Më pas, më datë 25 shkurt 2011, Prokurori ushtroi aktakuzë të veçantë PPS nr. 117/2010 (regjistruar nga Gjykata nën KA nr. 09/2011) kundër S.H.t duke e ngarkuar atë me dy akuza për krime lufte lidhur me të ndaluarit në kampin e UÇK-së në Cahan. Sipas kërkesës së Prokurorit të PSRK-së, më datë 2 mars 2011 Gjykatësi për Konfirmim lëshoi një Urdhër për të bashkuar lëndën penale KA nr. 09/2011 kundër S.H.t me lëndën penale KA nr. 208/2010 kundër H.H.t dhe S.R.t meqenëse veprat e pretenduara penale ndërlidheshin dhe mbështeteshin në të njëjtat prova. Më datë 25 mars 2011, Gjykatësi për Konfirmim lëshoi Aktvendimin KA nr. 208/2010 me anë të të cilit konfirmoi të dy aktakuzat dhe deklaroi të gjitha provat e përfshira në dosjen e lëndës si prova të pranueshme.

### **B. Shqyrtimi Kryesor**

3. Shqyrtimi kryesor kundër S.G.t dhe R. Alijat u deklarua i hapur më datë 14 mars 2011 para Trupit Gjykses të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, që përbëhej nga 2 Gjykatës të EULEX-it dhe 1 gjykatës kosovar. Më datë 14 prill 2011, Prokurori kërkoi që lënda kundër H.H.t, S.R.t dhe S.H.t të bashkohej me shqyrtimin kryesor kundër S.G.t dhe R.A.t. Më datë 4 maj, u hap shqyrtimi kryesor kundër H.H.t, S.R.t dhe S.H.t në lëndën P nr. 13/2011, gjithashtu në prani të të pandehurve S.G. dhe R.A. dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Të gjitha palët kanë rënë dakord që lëndët të bashkoheshin sepse megjithëse në shqyrtimin kryesor Geci/Alia ishin mbajtur tashmë 11 seanca, të gjitha dëshmitë e dëgjua deri në atë moment kishin të bënin me akte për të cilat pretendoheshin se janë zhvilluar në kampin e UÇK-së në Kukës, për të cilat akuzoheshin vetëm S.G. dhe R.A.. Akuzat kundër H.H.t, S.R.t dhe S.H. kishin të bënin me incidente të cilat pretendoheshin të kishin ndodhur në kampin e UÇK-së në Cahan. Për këtë arsye, nuk kishte ndonjë paragjykim kundrejt të pandehurve për të bashkuar lëndët. Pra shqyrtimi kryesor vazhdoi kundër pesë të pandehurve.
4. Më datë 16 qershor 2011, Avokati Mbrojtës Qasim Qerimi bëri kërkesë Trupit Gjykses që të lejonte të pandehurin S.R. të udhëtonte në Turqi sepse ai duhej që t'i nënshtrohej një operacioni urgjent në zemër. Më datë 20 qershor, Trupi Gjykses ndau lëndën kundër S.R.t sipas nenit 34 KPPK dhe shqyrtimi vazhdoi kundër katër të pandehurve të tjerë.
5. Fjalët përfundimtare u dëgjuan më datë 21 dhe 25 korrik 2011 dhe aktgjykimi lidhur me të akuzuarit S.G., R.A., H.H. dhe S.H. u shpall më datë 29 korrik 2011.

6. Më datë 12 tetor 2011 vazhdoi shqyrtimi kryesor në lëndën e ndarë kundër S.R.t dhe aktgjykimi u shpall më 13 tetor 2011.

### **C. AKTGJYKIMET**

7. I pandehuri S.G. u shpall fajtor për 4 akuza Krime lufte kundër popullatës civile, sipas neneve 22 dhe 142, KPRSFJ lidhur me nenin 3 të përbashkët, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1) PSH II (trajtimi çnjerëzor i të burgosurve civilë, torturimi i të burgosurve civilë, dhunimi i integritetit trupor i të burgosurve civilë me anë të keqtrajtimit dhe të rrahurave). S.G. u shpall gjithashtu fajtor për Pronësinë, kontrollin, posedimin dhe përdorimin e paautorizuar të armëve, sipas Nenit 328 (2) KPK.
8. S.G. u dënua respektivisht me 8, 12, 9 dhe 8 vjet burgim për secilën akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile. Për Pronësinë, kontrollin, posedimin dhe përdorimin e paautorizuar të armëve u dënua me gjobë prej 4,000.00 Euro. Dënimi unik u përcaktua 15 vjet burgim dhe gjobë 4,000.00 euro. Koha e kaluar në paraburgim u llogarit në dënim.
9. S.G. u lirua nga dy akuza për Krime lufte kundër popullatës civile (vrasje, dhënia e urdhrave për dhunimin e integritetit trupor të të burgosurve civilë).
10. I pandehuri R.A. u shpall fajtor për dy akuza për Krime lufte kundër popullatës civile, nenet 22 dhe 142, KPRSFJ dhe lidhur me nenin 3 të përbashkët, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1), PSH II (dhunim i integritetit trupor të të ndaluarve civilë).
11. R.A. është dënuar me 8 dhe 9 vjetë burgim për secilën akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile. Është përcaktuar dënimi unik prej 12 vjetëve burgim dhe do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim .
12. R.A. është liruar nga një akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile (trajtim çnjerëzor i të ndaluarve civilë).
13. I pandehuri H.H. është shpallur fajtor për një pikë të akuzës për Krime lufte kundër popullatës civile sipas neneve 22 dhe 142, KPRSFJ dhe lidhur me nenin e përbashkët 3, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1), PSh (torturë e të ndaluarit civil).
14. Ai është dënuar me 6 vjet burgim.
15. H.H. është liruar nga një akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile.

16. I pandehuri S.H. është shpallur fajtor për një akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile sipas neneve 22 dhe 142, KPRSFJ dhe lidhur me nenin e përbashkët 3, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1), PSH II (torturë e të ndaluarit civil).
17. Ai është dënuar me 7 vjet burgim.
18. S.H. është liruar nga një akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile.
19. S.R. është fajtor për një akuzë për Krime lufte kundër popullatës civile sipas neneve 22 dhe 142, KPRSFJ dhe lidhur me nenin e përbashkët 3, KGJ dhe nenet 4 dhe 5(1), PSH II (torturë e të ndaluarit civil).
20. Ai është dënuar me 5 burgim.
21. S.R. është liruar nga dy akuza për Krime lufte kundër popullatës civile.

#### **D. Procedura Ankimore**

22. Avokatët mbrojtës Mahmut Halimi dhe Haxhi Millaku ushtruan ankesë të përbashkët për S.G.n më 14 shkurt 2012. Avokati Mbrojtës Gezim Kollcaku ushtroi ankesë për R.A.jn më 15 shkurt 2012. Avokati Mbrojtës Gani Rexha ushtroi ankesë për H.H.n më 15 shkurt 2012. Avokati Mbrojtës Agim Lushta ushtroi ankesë për S.H.n më 13 shkurt 2012. Avokati Mbrojtës Qasim Qerimi ushtroi ankesë për S.R.n më 4 prill 2012. Të gjitha ankesat janë ushtruar brenda afatit ligjor. Më 25 janar 2013, Prokurori Ankimor nga EULEX Judit Eva Tatrai ushtroi mendim dhe parashtrësë në përgjigje ndaj ankesave në fjalë.
23. Më 13 janar 2013, lënda është transferuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë në Gjykatën e Apelit sipas nenit 39 (1), Ligji mbi Gjykatën, Ligji nr. 03/L-199.
24. Seanca e Gjykatës së Apelit është mbajtur më 10 shtator 2013.
25. Gjatë seancës së Gjykatës së Apelit, Trupi Gjykues bashkoi procedurën penale ndaj të pandehurit S.R. me lëndën ndaj të pandehurve S.G., R.A., H.H. dhe S.H..

## **II. Parashtrësja e palëve**

### **A. Ankesa e ushtruar për S.G.n**

26. Avokatët Mbrojtës të S.G.t propozuan lirimin e S.G. për të gjitha krimet e luftës, apo kthimin e lëndës në rishqyrtim apo të paktën rikualifikimin e veprës penale si një akuzë e vetme dhe dënimi të jetë më i lehtë.

27. Ankuesit pretendojnë se gjykata e shkallës së parë ka kryer shkelje esenciale të ligjit procedural sepse dispozitivi është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit. Sipas tyre, përfundimet të cilat arriti Trupi Gjykes se veprat e pretenduara penale janë kryer në territorin e palës së përfshirë në konflikt nuk janë të bazuara në faktet e vërtetuara. Krimet e pretenduara nuk janë kryer në territorin e një pale të përfshirë në konflikt të armatosur dhe prandaj, normat e ligjit humanitar nuk janë të zbatueshme. Shqipëria nuk ka qenë palë e përfshirë në konfliktin në mes të UÇK-së dhe Serbisë dhe fakti se disa ushtarë të UÇK-së ishin të pranishëm në Shqipëri nuk e ndryshon situatën. Gjykata e Qarkut nuk ia doli të vërtetojë të kundërtën. Aktgjykimit poashtu i mungon arsyetimi sepse kundërshtimet në mes të deklaratave të ndryshme të dëshmitarëve nuk janë vërtetuar dhe nuk ka prova që mbështetin përfundimin e Trupit Gjykes se S.G. kishte ndonjë pozitë në hierarkinë ushtarake në kampin në Kukës. Me argumentin se ekzistimi i bazave ushtarake të UÇK-së në Shqipëri bën që zonat përkatëse t'i bashkangjiten konfliktit dhe normat e ligjit ndërkombëtar humanitar u bënë të zbatueshme aty, Gjykata e Qarkut tejkaloi kompetencën e saj sepse pretendimet e tilla mund të bëhen vetëm nga njëra nga palët dhe jo nga gjykata.
28. Ankuesit besojnë se është shkelur e drejta materiale në dëm të të akuzuarve nga fakti se veprimet e S.G.t janë kualifikuar në mënyrë të gabimtë si bashkim real kur në fakt është dashur të konsiderohen si veprim ideal sepse të gjitha akuzat bien brenda një norme të njëjtë. Prandaj, ky është dashur të dënohet me një dënim të vetëm për të gjitha pikat e krimeve të luftës për të cilat është shpallur fajtor. Gjetja e Gjykatës së Qarkut se S.G. kishte ndonjë autoritet komandues në kampin në Kukës apo në atë në Cahan nuk është vërtetuar dhe solli hezitime që duhen interpretuar në favor të tij.
29. Avokatët Mbrojtës të S.G.t poashtu argumentojnë duke thënë se faktet janë vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë sepse përfundimet të cilat arriti Gjykata e Qarkut kanë injoruar mospërputhjet e mëdha në mes të deklaratave të dëshmitarëve dhe në mënyrë të gabuar ka bazuar aktgjykimin mbi deklaratat e dëshmitarëve , të cilat kishin kundërthënie në aspekte esenciale lidhur me praninë e rolit të S.G.t në kampin në Kukës (Dëshmitarët A dhe H), ndërsa duke lënë mënjanë si të pabesueshme dëshmitë konsistente të dëshmitarëve D dhe E. Deklaratat e Dëshmitarit I.I. janë poashtu të pabesueshme për shkak të kundërthënieve brenda tyre. Ankuesit vënë re se bazuar në provat dhe në faktin vërtetues se prania e tij në kampin në Kukës ishte sporadike, mund të arrihet deri te konkludimi i vetëm se S. Geci nuk kishte pozicion autoriteti as në kampin e Kukësit e as në atë në Cahan.
30. Avokatët Mbrojtës kanë gjetur se, sidoqoftë, dënimet për veprimet e S.G.t janë shumë të rënda dhe se faktorët lehtësues nuk janë marrë parasysh. Dënimi i S.G.t duhet zbutur tashmë për shkak të faktit se veprimet e tij (për krime lufte) duhen konsideruar si një vepër e posaçme penale.



## **B. Ankesa për R.A.jn**

31. Avokati Mbrojtës i R.A.jt propozon që lënda të kthehet për rigjykim, të lirohet R.A. apo të paktën t'i shpallet një dënim më i butë.
32. Ai gjen se Gjykata e Qarkut ka shkelur dispozitat e procedurës penale për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të sfiduar është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me veten e saj dhe me arsyetimin e aktgjykimit. R.A. është dënuar për rrahjen e dëshmitarëve K, M, N, O dhe I.I.n në një numër të papërcaktuar rastesh. Në të njëjtën kohë, Gjykata e Qarkut përcaktoi se I.I. ishte rrahur nga R.A. në vetëm dy raste dhe se dëshmitarët K dhe M janë goditur nga ai vetëm një herë. Në arsyetimin e aktgjykimit nuk është përcaktuar se dëshmitarët N dhe O janë goditur ndonjëherë nga R.A.. Ai nuk është dashur të dënohet për asnjë krim të kryer ndaj Dëshmitarit O se ky dëshmitar asnjëherë nuk është dëgjuar gjatë procedurës.
33. Shkeljet e ligjit të procedurës kanë sjellur deri te shkelja e së drejtës materiale në dëm të të pandehurit për shkak se veprimet e tij nuk përbëjnë veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata në mënyrë të gabuar ka gjetur se veprimet e R. Alijajt janë kryer në bashkim real edhe pse duke qenë kualifikuar si nën normën e njëjtë dhe të vetme të së drejtës materiale, është dashur të konsiderohen si bashkim ideal.
34. Situata faktike sa i përket të pandehurit R.A. është përcaktuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Deklaratat e dëshmitarit I.I. është dashur të shpallen të pabesueshme sepse këto deklarata nuk janë mbështetur me prova të tjera. I.I. po gënjente për shkak të urrejtjes ndaj të pandehurve. Në rradhitjen e parë fotografike, ai nuk ka mundur të njohë R.A.jn (fotografia nga viti 1999), por e njohu disa ditë më vonë (fotografi e re nga 2010), duke thënë se e kishte parë të pandehurin në media. Deklaratat e dëshmitarëve K dhe M fare nuk mbështetin deklaratat e I.I.t. Avokati Mbrojtës poashtu theksoi se R.A. kishte goditur dëshmitarët K dhe M vetëm kur po transportoheshin për në kampin në Cahan dhe se kjo gjë ka ndodhur vetëm për shkak se ishte një situatë në përgjithësi e tensionuar, ishte ky një gjest i pa konsideratë, por i paqëllimtë dhe për këtë gjë, i pandehuri mënjëherë u kërkoi ndjesë viktimave pastaj dhe prandaj veprimet e tij nuk duhet të konsiderohen si krime lufte.
35. Avokati Mbrojtës gjeti se R.A. është dënuar mjaft rëndë. Gjykata në mënyrë të gabuar ka besuar se rrethanë rënduese është periudha gjatë së cilës viktimat janë ndaluar në kampin në Cahan sepse R.A. nuk ka pasur ndikim mbi këtë gjë. Poashtu, numri i madh i viktimave në mënyrë të gabuar i është atribuar R.A.jt. Ai është dënuar vetëm për keqtrajtimin e tre personave. Lidhur me efektin që kishte të rrahurit në shëndetin fizik dhe mendor të viktimave, kjo gjë nuk mund të qëndrojë si rrethanë rënduese ngase viktimat janë rrahur vetëm në fillim të qëndrimit të tyre në kampin në Cahan dhe më vonë janë trajtuar në pajtim me standardet e njëjta sikurse ato të ushtarëve. Asnjë viktimë nuk ka sjellur prova për të

vërtetuar lëndimet trupore. Në anën tjetër, në mënyrë të gabuar, nuk mori parasysh rrethanat lehtësuese me përjashtim të gjendjes aktuale shëndetësore të R.A.jt. Rrethanat e tjera lehtësuese për t'u marrë parasysh janë: periudha e rëndë kur janë kryer veprat penale, para e as pas kësaj here R.A. asnjëherë nuk është akuzuar për kryerje të ndonjë vepre penale e as nuk është ushtruar ndonjë procedurë penale kundër tij; gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri është sjellur siç duhet; me dënimin e R.A.jt, gruaja e tij e sëmure do të mbetet pa përkujdesje.

### **C. Ankesa për H.H.n**

36. Avokati Mbrojtës i të pandehurit H.H. propozon që lënda të kthehet në rishqyrtim apo t'i urdhërohet një dënim më i butë.
37. Ankuesi gjen se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale. Aktgjykimi ka mungesë të arsytimit ngase ka kundërthënie të konsiderueshme në mes të aktgjykimit dhe përmbajtjes së procesverbaleve të seancave. Gjykata në mënyrë të gabuar ka përcaktuar se ka pasur rrahje të vazhdueshme të Dëshmitarit N. Madje, edhe sipas deklaratave të këtij dëshmitari, ishte vetëm një rrahje që zgjati vetëm rreth një orë. Trupi Gjykues nuk ka dhënë arsyen pse u është dhënë epërsi disa dëshmime përkundër disa të tjerave. Për më tutje, Gjykata e Qarkut nuk ka dhënë arsye pse deklaratave të Dëshmitarëve K, M dhe I.I.t nuk u është falur besimi sa i përket mohimit së të pandehurit H.H. për të rrahur Dëshmitarin N. Prandaj, deklaratata e Dëshmitarit N është hutuese, kundërthënëse dhe e pabesueshme.
38. Apeluesi konstaton se për shkak të këtyre shkeljeve situata faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo complete nga gjykata e qarkut dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të padrejtë në dëm të pandehurit H.H..
39. Edhe po qe se Gjykata e Apelit do të ishte e kënaqur me arsytimin e gjykatës së qarkut, dënimi i caktuar ndaj të pandehurit H.H. është shumë i rëndë. Gjykata gabimisht ka marrë parasysh sendin me të cilin pretendohet se është kryer krimi si rrethanë rënduese. Gjykata nuk i ka vënë peshë adekuate rrethanave lehtësuese përsa i përket H.H.t.

### **D. Ankesa në emër të S.H.t**

40. Avokati mbrojtës i të pandehurit S.H.t propozon që klienti i tij të lirohet. Argumentet kryesore të apeluesit janë si në vijim.
41. Së pari avokati mbrojtës deklaroi se gjykata e qarkut ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë aktgjykimi nuk përmban arsyetim adekuat dhe ekzistojnë kontradikta të konsiderueshme në mes dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit.

42. Faktet janë vërtetuar gabimisht (në veçanti lidhur me dëshmitarin N) në aktgjykimin e ankimuar, për shkak se ekzistojnë mospërputhje në deklaratat e N-it përse i përket faktit se kur është sjellë ai në kampin e Cahanit. Ka qenë gabim që ka pasur qasje të pjesshme në prova – kështu që në një aspekt deklaratat e dëshmitarit N janë konsideruar të besueshme dhe në aspektin tjetër jo. Prandaj, nuk është e qartë përtej dyshimit të arsyeshëm nga provat, se S.H. ka kryer krimin për të cilin është dënuar.
43. Këto shkelje kanë çuar në zbatimin e gabuar të së drejtës penale materiale në dëm të pandehurit.
44. Apeluesi pretendon se edhe po qe se Gjykata e Apelit do të pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Qarkut, dënimi i S.H.t është shumë i rëndë.

#### **E. Ankesa në emër të S.R.t**

45. Avokati mbrojtës i të pandehurit S.R.t propozon që S.R. të lirohet ose të kthehet për rigjykim.
46. Apeluesi argumenton se Gjykata e Qarkut ka shkelur në mënyrë esenciale dispozitat e procedurës penale, meqë ka kundërthënë në mes dispozitivit të aktakuzës dhe arsytimit. Arsyetimi i aktgjykimit është po ashtu kundërthënës në veten e tij. Prandaj, në dispozitiv S.Rexhepi është shpallur fajtor për (akuza 2) krime lufte kundër popullatës civile, megjithatë në aktgjykim është precizuar vetëm termi Krime Lufte nga neni 142 të KPRSFJ, neni 3 KGJ dhe nenet 4 dhe 5 (1) të PSH II. Nuk ka pasur konflikt të armatosur që zhvillohej në vendin ku pretendohet se janë kryer krimet dhe prandaj normat e të drejtës ndërkombëtare humanitare nuk kanë qenë të zbatueshme atje në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara. Pjesë e madhe e provave janë administruar nga Gjykata e Qarkut përpara aktvendimit për bashkimin e procedurës dhe vetëm pas kësaj ka filluar shqyrtimi gjyqësor ndaj S.R.t.
47. Gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo complete. Deklaratat e dëshmitarit N janë të pabesueshme, sepse ato janë kontradiktore. N-ja ka pasur mëri ndaj secilit që ka ndaluar atë. Prandaj deklaratat e tij nuk duhet të konsiderohen të besueshme. Deklaratat nuk janë konkrete. Fajësia e S.R.t nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata e Qarkut nuk ka vlerësuar secilën provë në lidhje me provat tjera. Gjykata ka dështuar po ashtu të analizojë hierarkinë komanduese në kampin e Cahanit dhe nuk ka vlerësuar veprimet e secilit të pandehur bazuar në atë hierarki.
48. Shkeljet më lartë kanë çuar në zbatimin e gabueshëm të së drejtës penale materiale në dëm të pandehurit. Bashkëkryerja duhet të absorbojë përgjegjësinë e sanksionuar nga neni 26 i KPRSFJ. Prandaj aktgjykimi i cili shpall të pandehurin fajtor në të dy pikat është i gabuar. Gjetjet në bashkëkryerjen e pretenduar nuk janë të bazuara në aktgjykim në asnjë mënyrë.

Avokati mbrojtës gjen se përgjegjësia e S.R.t në formën e bashkëkryerjes është e përjashtuar sepse nuk ka prova që ai ka përpiluar një plan me gojë ose me shkrim paraprakisht për të kryer krimet për të cilat është dënuar.

49. Avokati mbrojtës argumenton se edhe nëse shpallet fajtor, dënimi i S.R.t është shumë i rëndë, sepse rrethanat rënduese janë vërtetuar gabimisht dhe se nuk ka kontradikta me dëshmitë se S.R. ka qenë më njerëzor ndaj të ndaluarve se sa ushtarët tjerë të UÇK-së.

#### **F. Mendimi i Prokurorit të Apelit**

50. Më 25 janar 2013 Prokurorja e Apelit Judit Tatrai parashtroi një mendim në përgjigje në ankesa. Ajo i propozoi Gjykatës së Apelit të refuzojë ankesat dhe të vërtetojë aktgjykimin e kontestuar. Argumentet e saja përsa i përket secilës prej ankesave janë si në vijim.
51. Prokurori i apelit gjen se pretendimi i avokatëve mbrojtës të S.G.t përsa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 (1.12) të KPPK nuk është provuar dhe se aktgjykimin i ankimuar nuk përmban kësi shkelje. Ajo po ashtu gjen supozimet e avokatëve mbrojtës të gabuara për shkak të faktit se aktet ishin kryer jashtë territorit gjeografik të Kosovës, në një shtet i cili nuk është pjesë e konfliktit të armatosur dhe i cili nuk ka qenë shtet anëtar i NATO-s në vitin 1999, gjykatat në Kosovë nuk kanë juridiksion mbi lëndën në shqyrtim. Prokurori i apelit nuk pajtohet me pretendimet e avokatëve mbrojtës se gjykata e qarkut nuk është marrë me çështjen e provave kundërthënëse. Në kundërshtim me ankesat, prokurori i apelit gjen se gjykata thjesht e ka përmbushur obligimin e vet ligjor sipas nenit 7 (1) të KPPK që të vërtetojë sinqerisht faktet e lëndës, dhe nuk i ka tejkaluar kompetencat. Prokurori i apelit nuk pajtohet me pretendimet e avokatëve mbrojtës të S.G.t lidhur me çështjen e bashkimit të disa akuzave për Krime lufte kundër popullatës civile dhe gjen se aktet që dërguan te këto akuza ishin marrë parasysh drejt nga gjykata e qarkut si veprime kriminale të ndara dhe jo si një veprim i zgjatur kriminal. Për këtë arsye prokurori i apelit konstaton se deklaratat e avokatëve mbrojtës janë të gabuara se dënimi i shpallur është shumë i rëndë, dhe se një dënim i vetëm ishte dashur të shpallej në vend të bashkimit të dënimeve të ndara për katër akuzat për krime lufte. Në mospajtim me ankesën ajo po ashtu konstatoi se prania e S.G.t në Kukës dhe Cahan, dhe pyetja nëse për shkak të gjendjes së tij të dobët shëndetësore ai e ka përmbushur pozitën e tij komanduese ose jo, është çështje për vlerësimin e provave dhe jo e shkeljes së ligjit penal. Prokurori i apelit nuk pajtohet me deklaratimet e avokatëve mbrojtës në atë se gjykata e qarkut nuk i ka analizuar deklaratat kundërthënëse të dëshmitarëve dhe gjen se avokatët mbrojtës i referohen deklaratave relevante të dëshmitarëve jashtë kontekstit, dhe i shfaqin dëshmitë e tyre në mënyrë të shtrembëruar. Ajo mendon se gjykata e qarkut ka zbatuar një procedurë të plotë në marrjen e provave dhe ka përmbushur obligimin e vet ligjor në aktgjykim ashtu siç parashihet me nenin 387 (2) dhe nenin 396 (7) të KPPK lidhur me secilin dënim ndaj S.G.t. Gjykata e

shkallës së parë ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nuk ka devijuar nga përmbajtja e provave por ka dhënë një përshkrim të vërtetë të tyre.

52. Prokurori i apelit gjen se pretendimet e avokatit mbrojtës të R.A.jt lidhur me mospërputhjet në mes bazës dhe dispozitivit të aktgjykimit kontestues janë pa merita. Ajo vë re se aktgjykimi i ankimuar nën paragrafët 151, 163-164, 167-168, 172-173, 174, vërtetojnë qartë dhunimin e integritetit trupor të I.I.t, dëshmitarëve K, M, N dhe O, dhe në paragrafët 205-208 pozitën dhe autoritetin e R.A.jt në Cahan. Këto përcaktime bazohen në prova në aktgjykim. Prokurori i apelit argumenton në kundërshtim me avokatët mbrojtës se gjykata e qarkut ka përcaktuar gjendjen faktike drejt në këtë lëndë. Lidhur me bashkimin e veprave penale të Krimeve të luftës ndaj popullatës civile, prokurori i apelit i referohet argumenteve të saja të shpjeguara në ankesën e S.G.t. Ndryshe nga avokati mbrojtës i R.A.jt prokurori i apelit gjen se dënimi i shpallur është në linjë me ligjin penal dhe se faktorët rëndues dhe lehtësues të dënimit janë marrë parasysh në mënyrë të drejtë nga gjykata e qarkut.
53. Prokurori i apelit e gjen të gabuar pretendimin e avokatit mbrojtës të H.H.t gjoja se aktgjykimit të kontestuar i mungon arsyetimi dhe se ka pasur mospërputhje të konsiderueshme në mes deklaratës mbi bazat lidhur me përmbajtjen e dokumenteve apo procesverbaleve të dëshmitarëve. Sipas saj, nuk ekzistojnë mospërputhje në mes deklaratave të dëshmitarëve që referohen nga ankuesi. Vlerësimet e deklaratave dhe të peshës së tyre janë bërë në përputhje me dispozitat e procedurës penale dhe si rezultat gjykata e qarkut ka nxjerrë përfundim të drejtë mbi gjendjen faktike. Në kundërshtim me pretendimet e avokatit mbrojtës se dënimi është i tepërt, faktorët rëndues nuk janë vlerësuar drejtë dhe faktorët lehtësues gabimisht nuk janë marrë parasysh, prokurori i apelit konstaton se në fakt gjykata ka vlerësuar tentimin e të akuzuarit të lehtësojë shqetësimin e dëshmitarëve në robëri si faktorë lehtësues në dënimin e tij. Edhe pse dosja penale e pastër dhe gjendja ekonomike e H.H.t nuk janë vlerësuar nga gjykata, prokurori i apelit është i mendimit se dënimi i tij është prapë se prapë proporcional dhe në përputhje me ligjin.
54. Prokurori i apelit nuk pajtohet me avokatin mbrojtës të S.H.t gjoja se aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje esenciale të procedurës penale sipas nenit 403 (1.12) të KPPK, për shkak të kontradiktës në mes paragrafëve 159 dhe 258 në arsyetimin e aktgjykimit. Ajo tërheq vëmendjen në faktin se avokati mbrojtës pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me akuzën për të cilën S.H. është liruar. Faktikisht paragrafëve 159 dhe 258 të arsyetimit të aktgjykimit i janë bashkëngjitur Akuzës 2 të akuzave të konsoliduara, torturimi i dëshmitarit N më 9 maj 1999 në Cahan. Ky argument nuk është në favor të akuzuarit. Prokurori i apelit gjen se ankesa nuk pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me Akuzën 1 të akuzave të konsoliduara, torturimin e dëshmitarit N më 3 maj 1999 në Cahan. Prokurori i apelit gjen se pretendimi i avokatit mbrojtës lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo komplet të gjendjes faktike në këtë rast është i

pa meritë dhe bile pa mbështetje në argumentet e vetë ankesës së avokatit mbrojtës. Po ashtu argumentet për dënim të tepërt janë të pabazuara.

55. Në mospajtim me avokatin mbrojtës të S.R.t prokurori i apelit gjen se aktgjykimi i gjykatës së qarkut lidhur me S.R.n nuk bazohet në prova të administruara në shqyrtimin gjyqësor pa pjesëmarrjen e S.R.t dhe mbrojtësit të tij. Prokurori i apelit parashtron se aktgjykimi nuk përmban shkeljet e pretenduara po ashtu në bazë të asaj se bashkëkryerësit nuk kanë mundur të identifikohen akoma. Sipas nenit 22 të KPRSFJ bashkëkryerja ekziston “[nëse] disa persona bashkërisht kryejnë një vepër penale duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër [...]” Është e mjaftueshme të provohet se përveç S.R.t persona tjerë kanë marrë pjesë bashkërisht në kryerjen e aktit. Dhe në fakt është vërtetuar me prova. Edhe nëse nuk përmendet përgjegjësia penale personale e tij dhe aktgjykimi nuk përmend ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së duke vepruar në bashkëkryerje me S.R.n , bashkëkryerja prapë se prapë qëndron ku kemi H.H.n dhe S.H.n duke vepruar së bashku me të. Gjendja faktike është vërtetuar drejtë po ashtu lidhur me S.R.n dhe argumentet e ankesës që kundërshtojnë këtë mendim janë të pabazuara. Sipas avokatit mbrojtës gjykata ka shkelur ligjin penal sepse ka dënuar S.R.n për bashkëkryerje pavarësisht se kushtet paraprake të saj, siç janë plani i shkruar apo gojor i veprimit që i veçohet secilit bashkëkryerës, nuk është vërtetuar. Prokurori i apelit parashtron se ajo çka mbrojtja pretendon nuk kërkohet me ligj. Prokurori i apelit nuk e ndan këtë argumentim të avokatit mbrojtës përse i përket dënimit dhe parashtron se dënimi i caktuar ndaj S.R.t është proporcional dhe në pajtim me ligjin.

### **III. Gjetjet e Panelit**

56. Gjykata e Apelit konstaton në fillim se në disa pjesë, aty ky ankesat e avokatëve mbrojtës mbulojnë njëra tjetrën, paneli nuk do të diskutojë secilën ankesë ndarazi, por merret me argumentet identike të ankueseve bashkërisht.

#### **A. Shkelja e pretenduar e ligjit procedural**

57. Gjykata e apelit nuk pajtohet me argumentin se gjykata e qarkut ka bërë shkelje esenciale të normave të ligjit procedural, të theksuara nga ankuesit.
58. Avokatët mbrojtës për S.G.n dhe R.A.jn kontestojnë aktgjykimin e gjykatës së qarkut për shkak të kontradiktave brenda dispozitivit. Megjithatë, asnjë nga ankuesit nuk specifikon në cilin aspekt dispozitivi është në kontradiktë me veten e vetë. Paneli konstaton se si e tillë një kontradiktë vetëm një situatë mund të shihet, ku ka mospërputhje logjike në mes vendimeve të ndryshme të artikuluar nga gjykata në dispozitiv. Asnjë nga këto mospërputhje nuk janë referuar në ankesa dhe nuk mund të identifikohen nga ky panel në aktgjykimin e gjykatës së qarkut.

59. Në ankesat e avokatëve mbrojtës të S.G.t, R.A.jt, S.H.t dhe S.R.t është cekur se ka kontradikta në mes dispozitivit dhe arsytimit. Avokati mbrojtës i S.R.t sheh kontradikta po ashtu brenda arsytimit. Sikurse sa i përket argumenteve për kontradiktat brenda dispozitivit, gjykata e apelit nuk i sheh këto shkelje. Përfundimet e gjykatës së qarkut janë të bazuara në vlerësimet e fakteve dhe të ligjit dhe nuk ka kontradikta logjike në mes asaj çka është vërtetuar nga gjykata dhe që është konkluduar në bazë të tyre. Vetëm fakti se ankuesit nuk pajtohen me atë se çka është konkluduar nga gjykata, kjo nuk përbën shkelje e cila pohohet në ankesa.
60. Avokati mbrojtës i H.H.t sheh kontradiktë në mes arsytimit të aktgjykimit dhe procesverbalit të dëgjimit në faktin se H.H. është dënuar për rrahje të vazhdueshme të dëshmitarit N, edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësor ky dëshmitar foli vetëm rreth një rrahjeje. Gjykata e apelit nuk pajtohet me kritikën e ankuesit. Sipas dispozitivit të aktgjykimit të kontestuar H.H. është dënuar për torturimin e dëshmitarit N (së bashku me S.H.n dhe një pjesëtarë të pidentifikuar të UÇK-së) më 3 maj 1999 duke tentuar të merr informata dhe rrëfime nga ai derisa e ka rrahur atë vazhdimisht me shkopinj druri. Është e qartë për këtë formulim, se H.H. është dënuar vetëm për një incident, që zgjati një periudhë të gjatë. Gjatë kësaj periudhe H.H., së bashku me persona tjerë, ka qëlluar viktimën me shkopinj të drurit disa herë. Prandaj përdorimi i fjalës vazhdimisht është i duhur. Kjo megjithatë nuk i referohet në asnjë mënyrë sikur H.H. do të shpallej fajtor për dhunim të integritetit trupor të dëshmitarit në më shumë se një rast.
61. Në mënyrën e ngjashme avokati mbrojtës i R.A.jt gjen se klienti i tij është dënuar gabimisht për rrahjen e dëshmitarit I.I.t në një numër të paspecifikuar të rasteve, kur në të vërtetë ky dëshmitar ka deklaruar vetëm se ky i pandehur e ka rrahur dy herë. Gjykata e apelit konstaton se ajo që është pohuar nga avokati mbrojtës është e gabuar dhe nuk qëndron në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së qarkut. R.A. në të vërtetë është dënuar për dhunimin e integritetit trupor të I.I.t dy herë. Ai, megjithatë, është shpallur fajtor edhe për dhënien e urdhrave ushtarëve të pidentifikuar të UÇK-së që të grushtojnë dhe shkelmojnë I.I.n dhe kjo në të vërtetë në një numër të pidentifikuar të rasteve. Një konkludim i tillë nuk është në kontradiktë në asnjë mënyrë me deklaratën e dëshmitarit I.I. apo ndonjë provë tjetër e vlerësuar nga gjykata e qarkut. Përkundrazi, në seancën e datës 4 maj 2011, I.I. ka deklaruar se R.A. ka udhëzuar një femër të rrahë atë me shkop më 25 dhe 26 maj 1999.
62. Avokatët mbrojtës të S.G.t dhe S.R.t e kontestojnë konkludimin e gjykatës së qarkut përse i përket zbatueshmërisë së nenit 3 të përbashkët po ashtu nenit 142 të KPRSFJ respektivisht në këtë lëndë dhe gjen se një konkludim i tillë është në kontradiktë me atë që faktikisht është vërtetuar nga gjykata e qarkut. Gjykata e apelit nuk pajtohet me këtë argument. Në paragrafët 34-36 gjykata e qarkut shkruan si në vijim:

34. [...] sipas nenit 23(1)(i) të KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente të dëgjojnë lëndë penale ku përfshihen akuza për të cilat ligji lejon caktimin e dënimit penal prej së paku pesë vjet. Kjo përfshin çështjet për të cilat janë akuzuar të pandehurit në këtë aktakuzë.

35. Neni 22 i kombinuar me nenin 142 të KPRSFJ, të pasqyruar në nenet 23 dhe 120 të KPK jep juridiksion për të gjykuar Krimet e luftës ndaj popullatës civile në nivelin e gjykatës së qarkut.

36. Neni 106 i KPRSFJ pasqyrohet në nenin 101(2) të KPK, e shtrinë këtë kompetencë që të përfshijë vepra të cilat janë kryer nga qytetarë të RSFJ jashtë shtetit (e që domosdoshmërisht përfshinë territorin e Shqipërisë) dhe prandaj i jep kompetencë/juridiksion gjykatës së qarkut në Mitrovicë të gjykojë krimet e luftës që pretendohet se janë kryer nga S.G., R.A. dhe bashkëpandehurit tjerë.

63. Më tutje në paragrafët 42-46 gjykata e qarkut shton:

“42. Parimet thelbësore që mund të rrjedhin nga këto raste janë si në vijim:

1. Konflikti i armatosur ekziston kurdoherë kur ka përdorim të forcës së armatosur në mes të shteteve apo dhunë të vazhdueshme të armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose në mes të grupeve të tilla brenda një shteti. Nuk ka ndonjë kundërshtim të fortë nga mbrojtja ndaj pohimit se në kohën relevante ka pasur konflikt të brendshëm të armatosur në Kosovë.

2. Neni 3 i Përbashkët, kur zbatohet për civilët në veçanti (GC4), duhet të interpretohet në mënyrën më të gjerë të mundshme në të dy aspektet, edhe kohore edhe gjeografike, meqë po të veprohet ndryshe do të thotë të shkohet kundër qëllimit të këtyre dispozitave. Pra, nuk është e domosdoshme që të dëshmohet se konflikti i armatosur brenda një shteti ka ekzistuar në secilën komunë, mjafton që ka ekzistuar brenda një rajoni më të madh ku kanë ekzistuar komunat, me fjalë të tjera në tërë shtetin. Duhet të vërehet se në asnjë nga këto raste nuk është kërkuar shprehimisht nga TPNJ që të përcaktojë situatën ku ka ndodhur sjellja e pretenduar përtej kufirit ndërkombëtar në shtetin e tretë. Meqë TPNJ nuk ka shqyrtuar shprehimisht një situatë të tillë, mund të konsiderohet se asgjë në aktgjykimet e cituara nuk përjashton një situatë të tillë.

3. Ajo çfarë nevojitet është nexus/lidhja në mes të pandehurit, viktimës, sjelljes së pretenduar kriminale dhe konfliktit të armatosur dhe se sjellja e pretenduar ka ndodhur në territorin nën kontroll të njërës nga Palët në konflikt. Sa i përket fakteve të pretenduara të lëndës, thuhet se të pandehurit janë sjellë në mënyrën e pretenduar për shkak të anëtarësisë së tyre në UÇK, se viktimat janë përzgjedhur për trajtimin e pretenduar për shkak të besimeve apo simpatie të tyre lidhur me konfliktin e armatosur që ndodhte në atë kohë dhe se sjellja e pretenduar është shkaktuar për shkak të këtyre simpatie. Në çdo rast, sjellja e pretenduar ka ndodhur brenda kampeve të UÇK-së në Kukës dhe Cahan. Nuk ka fare dyshim se këto bien nën territorin nën kontroll të qartë të palës në konflikt, domethënë UÇK-së. Me fjalë të tjera, pretendohet lidhje e qartë në mes të të pandehurve, viktimave, sjelljes, trajtimit dhe kontrollit territorial. Asgjë në asnjërin nga rastet e cituara nuk parandalon që kjo të arrijë nivelin e krimit të luftës vetëm për shkak se vendndodhja gjeografike e ngjarjeve ishte në Shqipëri. Asgjë në sjelljen e pretenduar nuk privon këtë Gjykatë nga juridiksioni vetëm pse vendndodhja gjeografike e ngjarjeve është në Shqipëri.

43. Pra, për Trupin Gjykses është e qartë se ka juridiksion dhe kompetencë të gjykojë lëndë që përfshijnë persona me shtetësi të mëparshme Jugosllave dhe tani me shtetësi Kosovare për vepra



të cilat kanë ndodhur jashtë territorit të Kosovës ku veprat e pretenduara përbëjnë sjellje kriminale brenda Kosovës dhe se veprat penale të veçanta të pretenduara në aktakuzën aktuale, nëse veprat në fakt provohen, mund të klasifikohen si krime lufte, pavarësisht faktit se krimet e tilla kanë ndodhur brenda territorit të shtetit si palë e tretë Shqipërisë), e cila vetë nuk ishte palë në konflikt. Çfarëdo përfundimi tjetër do të shkonte kundër qëllimeve të qarta të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë dhe do të ishte në kundërshtim me kodin penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i cili ka përparësi, kodit aktual penal të Kosovës, formulimit të saktë dhe frymës së Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë dhe kundër çdo arsyeje të shëndoshë.

44. Gjatë kohës në fjalë ekzistonte edhe konflikt i armatosur i brendshëm edhe ndërkombëtar, në të cilin UÇK-ja ishte e angazhuar në një luftë çlirimtare kundër forcave të rregullta dhe jo të rregullta serbe, i atillë që përfshin dispozitat e Nenit 3 të Përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949, & Nenit 4 & 5(1) të PShII të vitit 1977.

45. UÇK-ja kishte themeluar dhe mbajtur kampe brenda Shqipërisë, në Kukës dhe Cahan. Këto kampe janë përdorë për një mori qëllimesh duke përfshirë logjistikën, strehimin tranzitor për ushtarë në rrugë e sipër për në luftime, stërvitje, administratë, shtab dhe objekt ndalimi në të cilin shqiptarët etnik nga Kosova që dyshoheshin për bashkëpunim me forcat serbe ndaloheshin, merreshin në pyetje dhe keqtrajtoheshin.

46. Pavarësisht vendndodhjes fizike të këtyre kampeve brenda territorit të Shqipërisë, ka ekzistuar një lidhje e qartë në mes të UÇK-së, viktimave të ndalimit dhe konfliktit të armatosur brenda Kosovës, që do të thotë se kjo është e mjaftueshme që veprat e tilla kriminale të cilësohen si krime lufte nëse vërtetohen si të tilla brenda kuptimit të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar.

64. Është e qartë nga fragmentet e lexuara më lartë se gjykata e qarkut së pari ka vërtetuar ekzistimin e konfliktit të armatosur në mes UÇK-së dhe forcave serbe dhe e dyta gjatë rrjedhës së këtij konflikti të vazhdueshëm të armatosur UÇK ka shfrytëzuar dhe në të vërtetë ka kontrolluar dy baza në territorin e Shqipërisë. Vetëm në bazë të këtyre fakteve të vërtetuara, gjykata e qarkut ka nxjerrë përfundim se neni 3 i përbashkët i KGJ dhe neni 142 i KPRSFJ janë të zbatueshëm në këtë lëndë. Prapë – kritikën e ngritura nga ankuesit do të ishin relevant vetëm nëse do të ekzistonte një kontradiktë logjike në mes arsyetimit dhe konkludimit të gjykatës. Një kontradiktë e tillë nuk është e pranishme në këtë lëndë.
65. Gjykata e apelit pajtohet me vlerësimin e gjykatës së qarkut përse i përket zbatueshmërisë së nenit 3 të përbashkët të KGJ përkatësisht nenit 142 të KPRSFJ po ashtu në të drejtën materiale.
66. Avokatët mbrojtës të S.G.t argumentojnë se do të ishte e drejtë vetëm e palëve të bëjnë pretendime përse i përket zbatueshmërisë dhe jo nga gjykata e qarkut *ex officio*. Mënyra se si e kuptojnë ankuesit është e gabuar. Vlerësimi, nëse një normë aplikohet në faktet e paraqitura në gjykatë në një rast në vazhdim e sipër, bie plotësisht në gjykatën – *iura novit curia*. Në fakt arsyeja e ekzistimit të një gjykate që vendosë mbi faktet është të ketë një autoritet të pavarur i cili do të merr parasysh faktet dhe argumentet e paraqitura nga palët

kontestuese dhe t'u tregojë palëve në mënyrë detyruese, cili është ligji përse i përket fakteve të paraqitura.

67. Aktgjykimi i gjykatës së qarkut është ankimuar nga avokatët mbrojtës të S.G.t, H.H.t dhe S.H.t edhe për shkak të mungesës së pretenduar të arsytimit brenda vetëvetes. Paneli nuk pajtohet me këto argumente, dhe i gjen të pabazuara dhe në kontradiktë me përmbajtjen e aktgjykimit të kontestuar. Ky panel është i mendimit se gjykata e qarkut ka bërë përpjekje të konsiderueshme të arsyetojë përfundimet e veta dhe të krahasojë provat e ndryshme. Kjo mes tjerash dëshkohet qartë me faktin se gjykata e qarkut ka liruar disa të pandehur nga disa akuza për të cilat ishin akuzuar, por gjithashtu nga një analizë e kujdesshme përse i përket besueshmërisë së dëshmive të dëshmitarëve dhe krahasimin e provave të ndryshme me njëra tjetrën në aktgjykim.
68. Avokati mbrojtës i R.A.jt argumenton se klienti i tij nuk është dashur të dënohet për asnjë nga krimet ndaj dëshmitarit O, për shkak se ky dëshmitar nuk është dëgjuar asnjëherë gjatë procedurës. Gjykata e apelit nuk pajtohet me ankuesin. Për të gjetur të pandehurin fajtor për një krim ndaj një palë të dëmtuar, absolutisht nuk është e obligueshme që pala e dëmtuar të merret në pyetje. Duhet të konstatohet se prokuroria është e lirë të zgjedhë, cilat prova dëshiron t'i përdorë në mbështetje të lëndës dhe bazuar në provat e paraqitura trupi gjykues është i lirë të merr vendim nëse prokuroria ka qenë e aftë të provojë rastin e tyre. Bazuar në provat e vlerësuara nga gjykata e qarkut, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se R.A. faktikisht ka rrahur këtë person. Dëshmitari I.I. ka deklaruar në seancë më 4 maj 2011 se ka dëgjuar dëshmitarin O duke bërë titur para se nxirrej jashtë dhomës së ndalimit. Kur është sjellë jashtë, dëshmitari O ka pasur lëndime nga rrahjet dhe këmbët i ishin mavijosur rëndë. Dëshmitari O i ka thënë I.I.t se R.A. dhe të tjerët e kanë rrahur atë pasi e kanë akuzuar se i është bashkuar FARK.<sup>1</sup>

### **B. Përcaktimi i fakteve**

69. Sipas ankuesve, Gjykata e Qarkut ka përcaktuar situatën faktike në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë.
70. Një ndër kritikën më të mëdha lidhur me përcaktimin e fakteve nga ana e Gjykatës së Qarkut ishte vërejtja se Trupi Gjykues ka vlerësuar në mënyrë joadekuate kundërthëniet në mes të deklaratave të ndryshme të dëshmitarëve dhe kundërthëniet brenda deklaratave të dëshmitarëve të caktuar. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me kritikë të tillë dhe gjen se ankuesit kanë në shënjestër aktgjykimin për vlerësimin e provave pa pasur ndonjë argument të arsyeshëm. Është privilegj i trupeve gjykuese të vlerësojnë provat që mësuan nga dora e

---

<sup>1</sup> I.I., procesverbal i shqyrtimit kryesor, 04 maj 2011, Q 183, 203-206.

parë gjatë shqyrtimit kryesor dhe kujton parimin e përcaktuar nga Gjykata e Qarkut në Kosovë në lëndën Runjeva, Akgami dhe Dema :

“[...] procedurat ankimore në KPPPK mbështeten në parimin se i takon trupit gjykues të dëgjojë, vlerësojë dhe peshojë provat në shqyrtimin kryesor. Trupi Gjykues në shqyrtim kryesor, si i atillë, me të dëgjuar dëshmitarët drejtpërsëdrejti, ka përparësinë e vëzhgimit të sjelljeve të tyre. Prandaj, ai ka pozitën më të mirë për të përcaktuar besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e tyre. Me kaq, kërkohet nga Gjykata e Apelit t’i përcaktojë trupit të përmendur gjykues një margjinë respektimi në përcaktimin e gjetjeve faktike. Nuk duhet t’u pengojë gjetjeve të trupit gjykues zëvendësimi apo përplotësimi i tyre përpos në rast se provat mbi të cilat trupi gjykues është bazuar nuk mund të pranohen si të arsyeshme nga asnjë gjykatë apo në raste kur vlerësimi i tyre ishte ‘plotësisht i gabuar’.

Sipas kësaj qasje, nuk është qëllimi i Gjykatës Supreme që kryesisht të rishqyrtojë gjetjet faktike të sjella nga gjykata e shkallës së parë, por të përqëndrohet për të kuptuar se a vlerësoi trupi gjykues provat në pajtim me logjikën dhe me përvojën njerëzore dhe nëse gjatë këtij procesi, ka vepruar brenda kufinjve të maturisë që i lejon ligji.”

71. Ç’është e vërteta, Gjykata e Qarkut ka bërë përpjekje të konsiderueshme në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve si dhe në krahasimin e deklaratave të dëshmitarëve me njëra-tjetrën dhe provat në dokumente, duke lënë mënjanë deklaratat që nuk janë mbështetur apo nuk kanë qenë konsistente. Gjetjet e gjykatës në fjalë ishin të logjikshme dhe në pajtim me përvojën njerëzore dhe si të tilla, mbesin brenda kufinjve të lejuar me ligj.
72. Sipas argumentit të sjellur nga Avokati Mbrojtës i R.A.jt, kërkimfalja e këtij të fundit dëshmitarëve K dhe M menjëherë të nesërmen e ditës kur i pandehuri kishte grushtuar viktimat, tregon se R.A. është njeri siç duhet dhe se veprimet e dhunshme ishin veçse gjeste të pamenduara mirë dhe të kryera nga emocionet dhe prandaj, nuk duhen kualifikuar si krime lufte. Trupi Gjykues gjen se pendimi i R.A.jt nuk bën që vepra penale e kryer nga ai të mos vazhdojë së ekzistuari.
73. Avokati Mbrojtës i S.G.t kundërshton gjetjen e aktgjykimit të sjellë nga Gjykata e Qarkut se S.G. kishte autoritet komandues në kampet në Kukës dhe në Cahan. Sipas ankuesit, S.G. ishte njeri i sëmurë, i cili nuk ishte në gjendje të kryente detyra komanduese dhe në fakt, ai nuk ka pasur ndonjë post në hierarkinë ushtarake në kampin e Kukesit e as në atë në Cahan. Prania e tij në dy kampet ishte veçse sporadike dhe e lidhur me arsye personale. Gjykata e Apelit gjen se pohimet e Avokatëve Mbrojtës janë mashtruese dhe nuk janë të bazuara në provat e vlerësuara nga Gjykata e Qarkut. Bazuar në një vlerësim të kujdesshëm të provave të dëshmitarëve, Gjykata e Qarkut ka ardhur deri te përfundimi se edhe provat nuk e bëjnë të qartë gradën e mbajtur nga S.G., ajo që është e qartë është se S.G. ishte anëtar i lart i UÇK-së, i cili kishte autoritet mbi ushtarët që ishin nën të dhe se ishte në pozitë për të dhënë urdhra. Gjykata e Apelit është e kënaqur me këtë përfundim dhe vë re aftësinë e një personi për të ushtruar autoritet mbi personat e tjerë është çështje fakti. Të qenurit përgjegjës për dhënien e urdhrave për kryerjen e veprave penale nuk e bën të nevojshme kriterin që person

që jep urdhrat e tillë mban post formal komandues. Ky Trup Gjykses është i bindur në gjendjen e Trupit nga Gjykata e Qarkut se në fakt, S.G. kishte autoritet të tillë mbi anëtarët e tjerë të UÇK-së të cilën përmbushën urdhrat e tij për të kryer vepra penale kundrejt palëve të dëmtuara në fjalë. Për pasojë, as fakti se sa gjatë ka qëndruar S.G. në kampet në Kukes apo Cahan nuk është i rëndësishëm.

74. Trupi Gjykses pajtohet me vlerësimin e Prokurorit të Apelit se aktgjykimi nuk përmban shkeljen e pretenduar edhe mbi bazën se bashkë-kryerësit nuk janë identifikuar ende. Sipas nenit 22, KPRSFJ bashkëfajësia ekziston “nëse disa persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër [...]” Mjafton për të dëshmuar se përpos S.R.t, persona të tjerë kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale. Në fakt, kjo gjë dëshmohet me provat. Edhe nëse në përgjegjësinë e tij personale penale nuk përmenden ushtarët e paidentifikuar të UÇK-së duke vepruar në bashkëfajësi/bashkëpunim me S.R.n, bashkëfajësia akoma ekziston duke qenë se H.H. dhe S.H. kanë vepruar së bashku me të. Prandaj, kritika e mbrojtjes së S.R.t lidhur me përcaktimin e gabuar të bashkë-kryerjes është e pakuptimtë. Avokati Mbrojtës poashtu argumentoi duke thënë se përgjegjësia e S.R.t në formë të bashkë-kryerjes përjashtohet ngase nuk ekzistojnë prova se ai paraprakisht, verbalisht apo me shkrim ka përpiluar planin për të kryer veprat penale për të cilat është dënuar. Trupi Gjykses vë re se asgjë e tillë nuk kërkohet me ligj. Neni 22, KPRSFJ lexon: “nëse disa persona së bashku kryejnë një vepër penale duke marrë pjesë në aktin e kryerjes së saj apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre do të dënohet siç parashihet me ligj.” Neni 31 i KPK-së përputhet me këtë. Të qenurit përgjegjës nuk kërkon që bashkë-kryerësi të ketë një marrëveshje paraprake për kryerjen e veprës penale. Mjafton që veprimet e bashkë-kryerësve janë të përbashkëta gjatë kryerjes së veprës penale.

### **C. Zbatimi i i së drejtës materiale**

75. Të gjithë parashtruesit konsiderojnë se për shkak të shkeljeve procedurale dhe konstatimit të gabuar të fakteve, e drejta materiale është zbatuar gabimisht në dëm të të akuzuarve. Meqenëse Gjykata e Apelit nuk ka konstatuar të ketë ndonjë shkelje të tillë, ky argument i parashtruesve të ankesave është i pa meritë.
76. Në ankesat që janë bërë në emër të të akuzuarve S.G. dhe R.A., është përmendur çështja e kualifikimit të ripërsëritjes së veprës penale. Gjykata e Qarkut i ka dënuar të dy këta të akuzuar për disa akuza të krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe u ka shqiptuar dënim të veçantë për secilën akuzë veç e veç, edhe pse të gjitha veprimet e tyre përkatëse shkelin një dhe të njëjtën normë të së drejtës materiale - nenin 142 KPRSFJ-së. Avokatët mbrojtës të këtyre dy të akuzuarve argumentojnë se klientët e tyre në fakt kanë kryer vetëm një krim dhe duhet të dënohen vetëm me një dënim. Prandaj, pyetja që shtrohet para Gjykatës së Apelit është, a duhet vepra e përsëritur penale e krimeve të luftës kundër popullatës civile siç parashihet me nenin 142 të KPRSFJ-së të kualifikohet si akuza të veçanta të ndryshme që përfundojnë me disa dënime veç e veç, d.m.t.th. në dënime për

secilën akuzë individuale apo duhet lëshuar vetëm një dënim për të gjitha veprimet e tilla duke i konsideruar së bashku. Neni 48 (1) i KPRSFJ-së parasheh se nëse një kryes i veprës penale me një vepër ose vepra të ndryshme **ka kryer disa vepra penale**, dhe nëse ai gjykohet për të gjitha veprimet në të njëjtën kohë (asnjëri prej të cilëve ende nuk është gjykuar), **gjykata së pari vlerëson dënimin për secilin veprim**, dhe pastaj vazhdon me përcaktimin e dënimit të integruar (dënimin unik) duke i konsideruar të gjitha veprimet së bashku. ( E njëjta gjë parashihet edhe me nenin 80 (1) të KPK-së). Nuk ekziston normë e prerë e qartë për situatën ku kryesi i veprës penale me disa veprime kryen vetëm një vepër penale. Megjithatë, nga norma e mësipërme është vetëm e logjikshme se formula e dhënë në nenin 48 (1) KPRSFJ nuk zbatohet në një rast të tillë dhe nëse një person me disa veprime kryen në mënyrë të përsëritur vetëm të njëjtën vepër penale, veprimet e tij duhet të kualifikohen si një vepër penale dhe se ai duhet të dënohet me vetëm me një dënim për të gjitha episodet individuale.

77. Kolegji pranon se Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë paraprakisht një pikëpamje tjetër mbi një çështje analoge. Këtë pikëpamje e ka përkrahur edhe Prokurori i Apelit i Shtetit në rastin në fjalë. Gjykata Supreme (duke vendosur si gjykatë e apelit, në përputhje me normat e procedurës penale të cilat kanë qenë në fuqi para datës 1 janar 2013) në çështjen penale kundër Latif Gashi *et alia*<sup>2</sup> ka pohuar si vijon:

" [ ... ] trajtimi i një sërë veprash të krimeve të luftës kundër popullatës civile vetëm si një "akt të zgjeruar kriminal" në pajtim me nenin 142 të KP RSFJ-së do t'i privilegjonte kryesit e veprave penale dhe kështu do t'u jipte sinjal të gabuar se sa më shumë që të kryhen vepra relevante, aq më mirë do të jetë për kryesit e veprave penale, atëherë kur të fillojë gjykimi. Nuk mund të jetë ky qëllimi i Ligjit i cili synon të mbrojë popullatën civile në mënyrën më efikase. Përveç kësaj, trajtimi i krimeve të luftës si "akte të zgjeruara kriminale" do të kishte për rezultat që prokurorisë t'ia pamundësojë që autorët e supozuar t'i konsiderojë përgjegjës për krime të ngjashme, gjë e cila gjithashtu do të arrinte nivelin e krimeve të luftës, kur këto krime të zbulohen rishtazi pas shpalljes fajtorë të kryesve përkatës për krime lufte më herët (*ne bis in idem*)."

78. Kjo gjykatë, megjithatë, do ta shihte më të udhës të trajtonte vetëm një veprim kryerja e të shtrihet përgjatë një periudhe kohore dhe i cili në të njëjtën kohë përshkohet nga një qëllim i përbashkët, si veprim i zgjeruar penal, ndërsa një përsëritje e thjeshtë e një krimi në vetvete nuk mund të konsiderohet gabimisht si veprim i zgjeruar. Në rastet kur e njëjta normë e ligjit penal shkelet në mënyrë të përsëritur por me qëllime të caktuara për secilin rast, të gjitha veprimet në fjalë duhet të kualifikohen si një vepër penale e njëjtë dhe dënohet me vetëm një dënim. Në teorinë e së drejtës penale kjo situatë njihet si një variant i bashkimit ideal të veprave penale. Një nga situatat tipike ku çështja e bashkimit ideal të veprave penale bëhet e rëndësishme është shkelja e normave të së drejtës penale që sjell një listë alternative të

<sup>2</sup> Ap.-Kž.Nr.89/2010, i datës 26 janar 2011

veprimeve të cilat të gjitha bien brenda normës së njëjtë (siç janë veprat penale të parapara me nenin 142 të KPRSFJ-së). Qasja të cilën e mbështet Gjykata Supreme dhe Prokuroria e Apelit e Shtetit do të gjente zbatim, megjithatë, vetëm me bashkimin e vërtetë të veprave penale, d.m.th. në situatën e përshkruar në nenin 48 (1) KPRSFJ-së ose 80 (1) të KPK-së.

79. Kjo qasje është pranuar gjerësisht në literaturën ligjore dhe praktikën gjyqësore anembanë Europës kontinentale. Gjykata e Apelit i referohet komenteve të nenit 142 të KPRSFJ-së nga L. Lazareviq:

"Veprimet e inkriminuara janë vënë në mënyrë alternative në ligj, në mënyrë që akti të mund të kryhet nga secili prej këtyre veprimeve. Megjithatë, nëse një person kryen disa veprime identike ose disa veprime të ndryshme të cilat inkriminohen në këtë nen, kjo do të jetë vetëm një vepër penale e krimit të luftës kundër popullatës civile, sepse në këtë rast, kjo rezulton nga vetë përshkrimi ligjor i veprës penale se ky është veprim unik penal pavarësisht nga numri i aktiviteteve të kryera individuale. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Kz-2539/56, ekziston një vepër penale e krimeve të luftës kundër popullatës civile edhe përkundër asaj nëse kryerësi kryen akte të veçanta në vende të ndryshme kundër personave të ndryshëm në periudha më të gjata kohore dhe në një mënyrë të ndryshme."<sup>3</sup>

80. Shqetësimi i ngritur nga Gjykata Supreme në rastin e përmendur e të cilin e mbështet Prokurori i Apelit i Shtetit, që do të kishte për rezultat që prokurorisë t'ia pamundësojë që autorët e supozuar t'i konsiderojë përgjegjës për krime të ngjashme, gjë e cila gjithashtu do të arrinte nivelin e krimeve të luftës, kur këto krime të zbulohen rishtazi pas shpalljes fajtorë të kryesve përkatës për krime lufte më herët (*ne bis in idem*, as ky shqetësim nuk është valid. Rregulla *ne bis in idem* e përjashton mundësinë për të gjykuar një person në mënyrë të përsëritur për të njëjtat fakte, por kjo në asnjë mënyrë nuk e pengon mundësinë që faktet e zbuluara rishtazi t'i kualifikojë sipas të njëjtës normë të së drejtës materiale penale.
81. Për arsyen e dhënë më sipër, Gjykata e Apelit i rikualifikon veprimet e S.G.t. I akuzuari S.G. shpallet fajtor për krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të KPRSFJ-së, të parapara gjithashtu me nenet 120 dhe 121 të KPK-së, dhe në shkëlje të nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit shtesë II, sepse ai:
- 5) nga 18 maji ose rreth asaj date e deri më 3 qershor 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") duke pasur pozitë komanduese në burgun e improvizuar brenda një kompleksi ushtarak të UÇK-së në qytetin e Kukësit në Republikën e Shqipërisë, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së bashkarisht ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore (p.sh. kushte të fëlliqta të jetesës, mungesë të higjienës adekuate, ushqimit dhe ujit) një numër të papërcaktuar të

<sup>3</sup> Lubisha Lazareviq, Komentar i Kodit Penal të RFJ-së, 1995, botimi i 5-të, "Savremena Administracija", Beograd

robërve civilë, duke përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitari C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED];

6) më datën 19 maj 1999 ose rreth asaj date, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së duke pasur pozitë komanduese në burgun në kampin e UÇK-së në Kukës, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së ka torturuar robër civilë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitarin F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED] duke u përpjekur që të marrin informata dhe rrëfime nga viktimat duke përdorur dhunë vazhdimisht kundër tyre dhe duke urdhëruar pjesëtarë tjerë të UÇK-së të bëjnë të njëjtën gjë;

7) disa herë nga data 18 maj ose rreth asaj date e deri më 3 qershor 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") duke pasur pozitë komanduese në burgun në kampin e UÇK-së në Kukës, i akuzuari ka përdhunuar integritetin trupor të një numri të papërcaktuar të robërve civilë duke përfshirë Dëshmitarin A, Dëshmitarin B, Dëshmitarin C, Dëshmitarin D, Dëshmitarin E, Dëshmitari F, Dëshmitarin H dhe A [REDACTED] B [REDACTED] duke i keqtrajtuar dhe rrahur brenda qelive të improvizuara ku mbaheshin ata robër;

8) më datën 12 prill 1999 ose rreth asaj date, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me R.A.jn, ka përdhunuar integritetin trupor të I.I.t, civil ky i arrestuar që mbahej në një burg të improvizuar në kampin e UÇK-së në Cahan, Republika e Shqipërisë, duke e rrahur atë vazhdimisht dhe rëndë me patericë dhe shkop druri.

82. Gjykata e Apelit gjithashtu i rikualifikon veprimet e R.A.jt. I akuzuari R.A. shpallet fajtor për krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të KPRSFJ, të parapara edhe me nenet 120 dhe 121 të KPK-së, dhe në shkelje të nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës dhe neneve 4 dhe 5 ( 1 ) të Protokollit Shtesë II, sepse ai:

3) më datën 12 prill 1999 ose rreth asaj, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S.G.n, ka përdhunuar integritetin trupor të I.I.t, civil ky i arrestuar që mbahej në një burg të improvizuar në kampin e UÇK-së në Cahan, Republika e Shqipërisë, duke e rrahur vazhdimisht dhe rëndë me patericë dhe shkop druri.

4) gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, ka përdhunuar integritetin trupor të këtyre civilëve robër në burgun në kampin e UÇK-së në Cahan :

- I.I.n, duke e rrahur atë në mënyra të ndryshme si duke e goditur atë më një këpucë të rëndë ushtarake më 14 prill 1999 ose rreth asaj date, dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së ta grushtojnë dhe shkelmojnë I.I.n në një numër të papërcaktuar të rasteve (sidomos kur I.I. po shkonte rrugës tij nga qelia ku ai mbahej për në tualet) në data të papërcaktuara mes 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999;

- Dëshmitarin M, duke e goditur vazhdimisht atë mbi kurrizin e tij me një shufër hekuri më 17 prill 1999 ose rreth asaj date;

- Dëshmitarin K, Dëshmitarin M, Dëshmitarin N dhe Dëshmitarin O duke i rrahur ata në disa mënyra, duke përfshirë edhe goditjen e tyre me shkop druri si dhe duke urdhëruar ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së t'i rrahin ata, në data të papërcaktuara diku në mes të 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999.

83. Avokati mbrojtës i S.R.t argumenton në ankesën e tij se klienti i tij është dënuar në mënyrë të paligjshme për veprën penale krime lufte si në formën e bashkëkryerjes sipas nenit 22 të KPRSFJ-së poashtu dhe sipas formës së përgjegjësisë të sanksionuar me nenin 26 të KPRSFJ-së (organizim i të bashkimit kriminal), edhe pse forma e fundit e përgjegjësisë duhet të absorbohet në bashkëkryerje. Gjykata e Apelit vëren se S.R. nuk është dënuar për organizim të bashkimit kriminal, kështu që rrjedhimisht argumenti i parashtruesit të ankesës është i pakuptimtë.

#### **D. Dënimi**

84. Në mënyrë analoge sa i përket argumenteve të parashtruesve të ankesave lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vëren se edhe çështja e përcaktimit të dënimeve qëndron kryesisht tek gjykata që mban gjykimin dhe tek gjykata e apelit. Kur është fjala për rishqyrtimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duhet përqendruar vetëm në gabimet procedurale ose substanciale që rrjedhin nga shqiptimi i dënimeve. Duhet theksuar se dënimet për H.H.n, S.H.n dhe S.R.n mbeten shumë poshtë mesatares së dënimit i cili zbatohet për veprën penale për të cilën janë akuzuar. Dënimi (dënimi unik) për S.G.n dhe R.A.jn është me të vërtetë i ashpër, por ata të dy janë dënuar sepse kanë kryer veprën e njëjtë më shumë se një herë. Prandaj argumentet e parashtruara në të gjitha ankesat se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë shumë të rënda janë të pa merito. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me asnjërin nga parashtruesit e ankesave, duke



argumentuar se as rrethanat rënduese nuk janë lënë anash gabimisht e as rrethanat lehtësuese nuk janë lënë anash në mënyrë të paligjshme pa u marrë në konsideratë si duhet nga Gjykata e Qarkut (avokatët mbrojtës të S.G.t, H.H.t dhe S.R.t). Gjykata e Qarkut ka vlerësuar në mënyrë korrekte ekzistencën apo mungesën e rrethanave rënduese dhe lehtësuese.

85. Meqë Gjykata e Apelit i rikualifikon veprimet për të cilat S.G. dhe R.A. janë akuzuar sipas nenit 142 KPRSFJ-së vetëm me një akuzë, dënimet e tyre për këto krime duhet rivlerësuar.
86. S.G. u dënua me nga 8, 12, 9 dhe 8 vjet burg për secilën akuzë të krimeve të luftës kundër popullatës civile. Gjykata e Apelit ia shqipton S.G.t dënimin me 15 vjet burg për krime të luftës kundër popullatës civile. Gjatë shqiptimit të këtij dënimi, kolegji merr parasysh si rrethanë rënduese faktorët e përmendur në paragrafin 267 të aktgjykimit të kontestuar kurse si faktor lehtësues gjendjen aktuale të shëndetit të S.G.t. Megjithatë, edhe pse Gjykata e Apelit pranon se S.G. ka nevojë për trajtim mjekësor dhe vuan nga lëndime dhe sëmundje të ndryshme, kolegji konstaton se duke pasur parasysh akuzat kundër tij dhe numrin e madh të faktorëve rëndues, gjendja e tij e keqe shëndetësore thjeshtë nuk duhet të çojë në zbutjen e dënimit. Për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, S.G. është dënuar me një gjobë prej 4,000.00 Euro. Dënimi unik është përcaktuar në 15 vjet burgim dhe një gjobë prej 4,000.00 Euro. Koha e kaluar në paraburgim i është llogaritur në këtë dënim. Gjykata e Apelit ia lë të pandryshuar dënimin unik S.G.t.
87. R.A. është dënuar me nga 8 dhe 9 vjet burgim për secilën akuzë të krimeve të luftës kundër popullatës civile. Gjykata e Apelit e dënon R.A.jn me 12 vjet burgim për krime të luftës kundër popullatës civile. Gjatë shqiptimit të këtij dënimi, ky kolegji merr parasysh si rrethanë rënduese faktorët e referuar në paragrafin 269 të aktgjykimit të kontestuar kurse rrethanë lehtësuese gjendjen aktuale shëndetësore të R.A.jt. Megjithatë, edhe pse Gjykata e Apelit pranon se S.G. ka nevojë për trajtim mjekësor dhe vuan nga lëndime dhe sëmundje të ndryshme, kolegji konstaton se duke pasur parasysh akuzat kundër tij dhe numrin e madh të faktorëve rëndues, gjendja e tij e keqe shëndetësore thjeshtë nuk duhet të çojë në zbutjen e dënimit.

#### **E. Çështjet tjera**

88. Për hir të interpretimit të saktë të ligjit, një çështje specifike me të cilën duhet marrë kur është fjala për aktgjykimin e kontestuar është çështja e veprës penale të torturës si krim në vete sipas ligjit ndërkombëtar në krahasim me torturën si krim lufte. Gjykata e Apelit vëren se në këtë drejtim, referenca që i bëhet nenit 1 të Konventës së KB-së kundër torturës të vitit 1984, në arsyetimin e të dyjave aktgjykimeve kontestuese është e pasaktë sepse secili prej këtyre krimeve ka elemente konstitutive të ndryshme. Sipas nenit 1 të Konventës kundër Torturës krimi kërkon : a) çdo akt me të cilin personit i shkaktohet dhembja ose vuajtje e rëndë; b) me qëllime nga ose një person i tretë të mirren informata ose ndonjë rrëfim, duke

e ndëshkuar atë, apo frikësuar ose duke i bërë presion atij apo një personi të tretë, ose për çfarëdo arsye të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji; c) nxitja, miratimi apo pranimi e një zyrtari publik ose një personi tjetër që vepron në një cilësi zyrtare. Tortura si krim lufte nuk e kërkon këtë elementin e fundit. Mjafton kur dhimbja ose vuajtja e rëndë i shkaktohen qëllimisht një personi në mënyrë që të arrihen qëllimet e caktuara ( marrja e informatës ose e rrëfimit, ndëshkimi, frikësimi, presioni). Kjo është e qartë nga të dyja dokumentet ku përcaktohen krimet e luftës - shih p.sh. Elementet e Krimeve të miratuara nga Asambleja e Shteteve Palë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale - Neni 8 (II) (a) ( ii) dhe 8 (II) (c) (i) ose; si edhe nga jurisprudenca - shih p.sh. Aktgjykimin e GjPNH të 22 shkurtit 2001, *Prokurori vs Kunarac et al* , paragrafi 496. Prandaj, në rastin konkret, nuk do të jetë e ndonjë rëndësie nëse S.G. apo S.R., kur u dënuan për torturë, kishin ndonjë pozitë me autoritet.

89. Megjithatë, pavarësisht nga ajo që u tha më lart, kolegji konstaton se konkluzionet e Gjykatës së Qarkut janë adekuate kur konstaton se të pandehurin janë fajtorë për krime të luftës kundër civilëve *inter alia* në formën e torturës. Provat të cilat i ka vlerësuar Gjykata e Qarkut në këtë drejtim çojnë medoemos kah një përfundim i tillë.
90. Kolegji gjithashtu e sheh të nevojshme të tërheq vëmendjen në arsyetimin aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut të 13 tetorit 2011. Më konkretisht, duke iu referuar dëshmime të vlerësuara të dëshmitarëve dhe dokumenteve të administruara në procesverbal, të dyja aktgjykimet e kontestuar: ato që kanë të bëjnë me të akuzuarit S.G., R.A., H.H. dhe S.H., të datë 29 korrik 2011, dhe ato që kanë të bëjnë me të akuzuarit S.R. të datës 13 tetor 2011 janë në pjesën më të madhe identike (ekzistojnë vetëm disa dokumente shtesë të përmendura në aktgjykimin e fundit). Megjithatë, duhet theksuar se sa i përket të akuzuarit S.R.t, çështja penale i ishte bashkuar gjykimin që ishte në vazhdim e sipër kundër të akuzuarve S.G.t dhe R.A., më vonë përsëri ishte veçuar dhe se aktgjykim i veçantë ishte lëshuar në lidhje me të. Ai akuzohej në aktakuzë vetëm për aktivitetet e tij në kampin e Cahanit. Prandaj të gjitha dëshmitë relevante që kanë të bëjnë vetëm me veprimet e kryera në kampin e Kukësit (lidhur me të akuzuarit S.G.t dhe R.A.) janë krejtësisht jorelevante kur është fjala për të arritur në përfundim për fajësinë ose pafajësinë e tij. Prandaj, referenca që i bëhet dëshmime të tilla në aktgjykimin e 13 tetorit 2011 të Gjykatës së Qarkut është e panevojshme. Vetëm provat, mbi të cilat bazohet aktgjykimin i marrë kundër një të pandehuri, duhet të përfshihen në aktgjykim. Çdo gjë tjetër është vetëm konfuzë dhe mund të ngrejë keqkuptime në drejtim të konkluzioneve tek të cilat ka arritur Gjykata.

91. Për arsyet e mësipërme, Gjykata e Apelit vendos si në dispozitiv.

*Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë kjo e autorizuar.*

Kryetari i kolegjit

\_\_\_\_\_  
Tore Thomassen  
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtarja e kolegjit

Procesmbajtësi

\_\_\_\_\_  
Bertil Ahnborg  
Gjyqtar i EULEX-it

\_\_\_\_\_  
Fellanza Kadiu  
Gjyqtare

\_\_\_\_\_  
Andres Parmas  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit e KOSOVËS  
Pakr 966/2012  
2 tetor 2013